



AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

Buletini i Njoftimeve Publike

Nr.47

Datë 01.09.2025

Agjencia e Prokurimit Publik

Blv "Dëshmorët e Kombit"

Tel: + 355 4 2277510

e-mail: info@app.gov.al

<https://www.app.gov.al>



KREU I PARË

Buletini i Prokurimit Publik

do të zhvillohet sipas Statutit dhe Rregullores të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës.

- Nuk lejohet paraqitja e dokumentacionit dorazi.
- Afati për dorëzimin e dokumentave është 10 (dhjetë) ditë kalendarike nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

Kandidatët për personel akademik me kohë të pjesshme, që kanë qenë të angazhuar në vitet akademike të mëparshme, duhet të dërgojnë vetëm formularin e aplikimit, lejen nga punëdhënësi për tu angazhuar për mësimdhënie pranë Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, si dhe të përditësojnë dosjet përkatëse të prezantuara më parë (nëse kanë), nëpërmjet shërbimit postar, brenda këtij afati.

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
NJOFTIM

Mbi shpalljen e thirrjes për aplikim në zbatim të VKM 348, datë 29.04.2020, “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes së punësimit, nëpërmjet vetëpunësimit” i ndryshuar.

Në zbatim të Programit të Qeverisë, Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për aplikimin në Programet e Nxitjes së Punësimit, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA), në Buletinin e Njoftimeve Publike, Nr.5, datë 27.01.2025, ka njoftuar hapjen e aplikimeve për programet e Nxitjes së Punësimit, shpërndarjen e fondit dhe pjesëmarrësve në Programet e Nxitjes së Punësimit, me fondet e akorduara nga Buxheti i shtetit për vitin 2025.

Në zbatim të VKM 348, datë 29.04.2020, “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes së punësimit, nëpërmjet vetëpunësimit” i ndryshuar, Kreu III, “Rregullat dhe procedurat për përfitimin e programit të vetëpunësimit” pika 1, AKPA, shpall thirrjen ku ftohen të gjithë punëkërkuessit e papunë e regjistruar në Zyrat Vendore të Punësimit, që kanë një ide biznesi, të marrin pjesë në këtë program.

Afati i aplikimit në programin e Vetëpunësimit për të gjithë punëkërkuessit e papunë të regjistruar në Zyrat Vendore të Punësimit është 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data e shpalljes së thirrjes në Buletinin e Njoftimeve Publike.

Aplikuesit duhet të jenë punëkërkuess të regjistruar në Zyrat Vendore të Punësimit dhe të kenë një ide biznesi. Përfitues të këtij programi do të jenë deri 100 (njëqind) punëkërkuess të papunë dhe deri në 100

(njëqind) të rinj aplikantë në skemën e garancisë rinore. Klasifikimi i përfituesve do të kryhet mbi fondet në dispozicion, vlerësimin nga ekspertë të jashtëm dhe vlerësimin nga komisioni i ngritur në Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.

Aplikimi do të kryhet në portalin e-Albania, në seksionin “PUNA”, në shërbimin “Kërkesë për pjesëmarrje në Programin e Vetëpunësimit”.